



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6551 Prot.

Tiranë, më 18.10. 2023

URDHËR

Nr. 592, Datë 18.10.2023

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
"BACHELOR" NË "INXHINIERI MEKANIKE", NË PROGRAM TË PËRBASHKËT
STUDIMI TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË "INXHINIERI MEKANIKE", NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË DHE NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË BARIT, ITALI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", në program të përbashkët studimi "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e dyfishtë në "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe në fakultetin respektiv në Universitetin Politeknik të Barit, Itali, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të përbashkët të studimit, të ciklit të parë "Bachelor" në "Inxhinieri Mekanike", në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë dhe në fakultetin respektiv në Universitetin Politeknik të Barit, Itali, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ALBANA TOLE

Albana Tole

